



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 652 Akti

Nr. 625 Vendimi
Tiranë, më 20.02.2023

VENDIM

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Olsi Komici	Kryesues
Firdes Shuli	Relatore
Valbona Sanxhaktari	Anëtare

asistuar gjatë procesit të vendimmarrjes nga sekretarja gjyqësore, znj. Ertugena Sokoli, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare, znj. Marie Tuma, në datën 20.02.2023

, mori në shqyrtim, mbi bazë dokumentesh, çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Markelian Kuqo**, ish-gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë.

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b** i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;
Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;
Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;
Vendimi nr. 78, datë 12.12.2017, i Gjykatës Kushtetuese.

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Z. Markelian Kuqo është subjekt rivlerësimi për shkak të funksionit si gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë dhe bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i është nënshtruar procesit të rivlerësimit *ex officio*.

2. Në datën 15.12.2020, në përputhje me rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, u zhvillua procedura e shpërndarjes së çështjeve me short, ku rezultoi se subjekti i rivlerësimit Markelian Kuqo do t’i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Valbona Sanxhaktari, Olsi Komici dhe Firdes Shuli. Relatore e çështjes u zgjodh komisionere Firdes Shuli.

3. Trupi gjykues i shortuar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni), me vendimin e datës 21.12.2020, vendosi fillimin e hetimit administrativ të thelluar dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesues të trupit gjykues komisioner Olsi Komici. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

4. Në datën 4.3.2021, përmes postës elektronike, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit për fillimin e procesit të rivlerësimit dhe përbërjen e trupit gjykues që do të kryente procesin e tij të rivlerësimit. Subjekti nuk u shpreh mbi ndonjë gjendje të konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues.

5. Menjëherë pas hedhjes së shortit, bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, u administruan raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK) dhe Këshillit të Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ).

6. KLGJ-ja¹ informoi Komisionin se me vendimin nr. ***, datë 10.12.2020, “Për caktimin e masës disiplinore ndaj gjyqtarit Markelian Kuqo”, ky institucion ka vendosur: (i) pranimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë; (ii) shkarkimin nga detyra të magjistratit Markelian Kuqo, me detyrë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë; (iii) pezullimin e përfitimit të pagës në masën 50%, si dhe përfitimet e tjera të magjistratit Markelian Kuqo, deri kur ky vendim të marrë formë të prerë; (iv) kundër këtij vendimi lejohet ankim sipas ligjit në Gjykatën Kushtetuese, afati i të cilit fillon nga e nesërmja e njoftimit të arsyetimit të këtij vendimi.

7. Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 140, pika 2/b, përcakton në mënyrë taksative se gjyqtari shkarkohet nga detyra, ndër të tjera, kur kryen shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës.

8. Gjykata Kushtetuese² ka informuar Komisionin se ndaj vendimit të KLGJ-së, në datën 19.1.2021, subjekti Markelian Kuqo ka paraqitur ankim në Gjykatën Kushtetuese, duke kërkuar shfuqizimin e vendimit nr. ***, datë 10.12.2020, të KLGJ-së. Në lidhje me këtë ankim, me vendimin nr. 35, datë 26.2.2021, Kolegji i Gjykatës Kushtetuese ka vendosur moskalimin e çështjes për shqyrtim në seancë plenare. Në këtë vendim arsyetohet se kompetenca për të marrë në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve disiplinore të KLGJ-së për vendosjen e masave disiplinore ndaj gjyqtarëve për periudhën e mandatit 9-vjeçar të funksionimit të Kolegjit, i është dhënë këtij të fundit.

9. Kolegji³ ka informuar Komisionin se pranë këtij institucioni, mbi bazën e kërkesës së ankuesit Markelian Kuqo është regjistruar çështja me nr. (JD) 2/2021, datë 26.3.2021, me objekt “shfuqizimi i vendimit nr. ***, datë 10.12.2020, të KLGJ-së, ‘Për caktimin e masës disiplinore ndaj gjyqtarit Markelian Kuqo’, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”.

¹Shihni shkresën “Njoftim vendimi”, me nr. *** prot., datë 14.12.2020, nga KLGJ-ja dhe shkurtim vendimi bashkëngjitur kësaj shkrese në dosjen e Komisionit.

²Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 6.5.2021, nga Gjykata Kushtetuese në dosjen e Komisionit.

³Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 7.5.2021, nga Kolegji në dosjen e Komisionit.

10. Me vendimin nr. 3, datë 7.12.2022⁴, Kolegji ka vendosur mospranimin e ankimit të z.Markelian Kuqo kundër vendimit nr. ***, datë 10.12.2020, të KLGJ-së “Për caktimin e masës disiplinore ndaj gjyqtarit Markelian Kuqo”. Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë, dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare. Ky vendim është publikuar në Fletoren Zyrtare⁵ nr. 4, datë 11.1.2023.

II. ARSYET E PËRFUNDIMIT TË PROCESIT TË RIVLERËSIMIT

11. Procesi i rivlerësimit që kryhet nga Komisioni është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

12. Trupi gjykues konstaton se z. Markelian Kuqo ka qenë me funksion gjyqtar pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Korçë, duke qenë kështu në rrethin e subjekteve që i nënshtrohen procesit të rivlerësimit *ex officio*.

13. Trupi gjykues u njoh me vendimin nr. ***, datë 10.12.2020, të KLGJ-së, për shkarkimin nga detyra të subjektit Markelian Kuqo, gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Korçë, për shkelje të rënda profesionale që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës, sipas procesit të iniciuar nga ILD-ja.

14. KLGJ-ja⁶ ka arritur në konkluzionin se veprimet/mosveprimet e ndërmarra nga ana e magjistratit Markelian Kuqo që parashikohen si shkelje disiplinore nga neni 101, pika 1, germa “b” dhe neni 102, pika 2, germat “a” dhe “b” të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, përbëjnë shkelje shumë të rënda disiplinore dhe që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës dhe ka vendosur dhënien e masës disiplinore “shkarkim nga detyra”, e parashikuar në nenin 140, pika 2, germa “a” e Kushtetutës dhe neni 111 i ligjit “Për statusin”.

15. Pas ushtrimit të së drejtës së ankimit, vendimi i KLGJ-së u la në fuqi nga Kolegji, vendimi i së cilës është përfundimtar, i formës së prerë, dhe ka hyrë në fuqi me botimin në Fletoren Zyrtare në datën 11.1.2023.

16. Në referim të germës “ç” të pikës 1 të nenit 64 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” ku, ndër të tjera, përcaktohet se *statusi i magjistratit mbaron në rastet kur shkarkohet nga funksioni*, subjekti i rivlerësimit nuk gëzon statusin e magjistratit.

17. Trupi gjykues ka arritur në përfundimin se mbarimi i statusit të magjistratit sjell si pasojë përfundimin e kësaj procedure administrative, pa një vendim përfundimtar për çështjen.

18. Neni 95 i Kodit të Procedurave Administrative ka parashikuar pamundësinë në objekt apo qëllim ku, sipas kësaj dispozite, organi publik deklaron të përfunduar procedurën administrative pa një vendim përfundimtar për çështjen, kur objekti për të cilin kishte nisur procedura apo qëllimi i tij është bërë i pamundur.

⁴Shihni vendimin e publikuar në faqen zyrtare të Kolegjit: https://kpa.al/wp-content/uploads/2023/01/Vendim-Markelian-Kuqo-perfshire-mendimin-e-pakices_anonimizuar-pdf-1.pdf

⁵ <https://qbz.gov.al/eli/fz/2023/4/ffdcfc72-8ece-4974-be22-fbc2072db8bc>

⁶Shihni vendimin e publikuar në faqen zyrtare të KLGJ-së: <https://klgj.al/wp-content/uploads/2021/01/VENDIM-NR.-633DAT%c3%8b-10.12.2020-P%c3%8bR-CAKTIMIN-E-MAS%c3%8bS-DISIPLINORE-NDAJ-GJYQTARIT-%e2%80%a6-1.pdf>

19. Në zbatim të kësaj dispozite, në kushtet kur subjekti i rivlerësimit nuk gëzon statusin e magjistratit, trupi gjykues vlerëson të përfundojë procesin e rivlerësimit kalimtar për z. Markelian Kuqo, pa një vendim përfundimtar.

PËR KËTO ARSYE,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, mbështetur në pikën 6 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në pikën 2/b të nenit 140 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në gërmen “ç” të pikës 1 të nenit 64 të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në nenin 95 të Kodit të Procedurave Administrative, të ndryshuar.

V E N D O S I:

1. Të deklarojë të përfunduar procesin e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit Markelian Kuqo, pa një vendim përfundimtar, për shkak se subjekti i rivlerësimit ka humbur statusin e magjistratit.
2. Ky vendim u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të tij dhe duhet të dorëzohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
4. Ankimi depozitohet pranë Komisionit të Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në datën 20.02.2023.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Olsi KOMICI
Kryesues

Firdes SHULI
Relatore

Valbona SANXHAKTARI
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Ertugena Sokoli